




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI

RAPORTI Dhjetor 2025



DATE/A:	16.03.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Faton Peci Kryetar i Komunës së Mitrovicës
CC:	Sekretaria e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Drejtorja për Shëndetësi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Dhjetor i Drejtorisë për Shëndetësi për vitin 2025



MITROVICË

2025

Drejtoria për Shëndetësi

Drejtoria e Shëndetësi kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

- 1.1. Sigurimin dhe zbatimin e kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e , gjendjes shëndetësore të qytetarëve, obligohet të zbatojë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor;
- 1.2. Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuara në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë, pozitës ekonomiko-sociale të qytetarëve, kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor, kushteve teknologjike, mjekësore, distancës, konfiguracionit gjeografik, dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- 1.3. Harton Planin operativ të zhvillimit të kujdesit parësor shëndetësor, plani i procedohet Kuvendit të Komunës për miratim paraprak dhe e miraton Ministria në propozim të Kuvendit të Komunës, në pajtim me planin afat-mesëm të miratuar nga Qeveria;
- 1.4. Organizon dhe zbaton mbikëqyrjen profesionale, juridike dhe financiare të shëndetësisë primare;
- 1.5. Vlerëson nevojat dhe përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- 1.6. Planifikon, harton dhe menaxhon buxhetin e kujdesit primar shëndetësor, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- 1.7. Vlerëson nevojat lokale për shëndetësinë primare;
- 1.8. Zbaton dispozitat ligjore dhe Rregulloret komunale në fushën e shëndetësisë primare;
- 1.9. Mbikëqyr situatën epidemiologjike në nivel të Komunës;
- 1.10. Kujdesin shëndetësor mendor të bazuar në bashkësi;
- 1.11. Mbikëqyrë dhe koordinon Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF);

- 1.12. Monitoron dhe kërkon raportime periodike dhe vjetore nga QKMF;
- 1.13. Ndërmerr fushata sensibilizuese me faktor tjerë dhe organizata në drejtim të preventivës dhe ruajtjes së shëndetit për qytetarët e Komunës;
- 1.14. Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- 1.15. Zbaton vendimet e Kryetarit dhe vendimet e Kuvendit Komunal;
- 1.16. Ushtron kompetenca të tjera dhe përgjegjësi duke zbatuar dispozitat ligjore, Statutin e Komunës, dhe aktet tjera nënligjore të Institucioneve të nivelit qendror;
- 1.17. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare;

Organizimi i Drejtorisë së Shëndetësisë

1. Drejtoria e Shëndetësisë, detyrat dhe përgjegjësit e veta i ushtron përmes:

1. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare;
2. Sektori për Administratë dhe Financa në Shëndetësi

1.Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

- 1.1. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës së Komunës së Mitrovicës;
- 1.2. Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të qasshme për gjithë komunitetin pavarësisht përkatësisë etnike, gjinore, besimit fetar;
- 1.3. Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të qasshme grupeve të cënueshme, si dhe personave me nevoja të veçanta;
- 1.4. Ofrimin e shërbimeve shëndetësore në rrjetin e institucioneve shëndetësore për popullatën e Komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës;
- 1.5. Sigurimin e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe kompetente për ofrim të shërbimeve cilësore në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor;
- 1.6. Sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit të institucioneve shëndetësore;
- 1.7. Sigurinë e personelit dhe pacientëve përgjatë procesit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore;
- 1.8. Vlerësimin dhe monitorimin i shërbimeve cilësore dhe kosto-efikase;
- 1.9. Riorganizimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në situata të jashtëzakonshme emergjente;
- 1.10. Trajtimi dhe menaxhimi i kërkueseve të shërbimeve të bazuara në praktikat më të mira

shkencore;

1.11. Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të popullatës së Komunës së Mitrovicës përmes vaksinimit dhe imunizimit të popullatës bazuar në rekomandimet e IKSHP/MSH;

1.12. Promovimin shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet;

1.13. Përfshirja dhe pjesëmarrja aktive e shfrytëzuesve, popullatës, në procesin e planifikimit dhe vlerësimit të shërbimeve shëndetësore si dhe pjesëmarrja në proceset e vendim marrjes;

1.14. Realizimin e buxhetit të QKMF-së;

1.15. Bashkëpunimin dhe kooperimin me DSH dhe të gjitha palët e interesit.

2. Sektori për Administratë në Shëndetësi

Sektori për Administratë në Shëndetësi kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

2.1. Ndhmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës, për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe përgatitë planin dhe raportet e punës për sektorin;

2.2. Asiston në hartimin e strategjisë shëndetësore, vlerësimin e nevojave lokale në aspektin Shëndetësor;

2.3. Planifikon, Përgatitë, analizon, rekomandon dhe monitoron Buxhetin e Drejtorisë për shëndetësi si dhe institucioneve shëndetësore të cilat i raportojnë Drejtorisë;

2.4. Koordinon punët me sektorët brenda Komunës dhe institucioneve varëse që kanë mundësi për zgjidhje;

2.5. Kujdeset, monitoron dhe vlerëson gjendjen infrastrukture të institucioneve shëndetësore , në bashkëpunim me drejtorin dhe menaxhmentin e QKMF-së planifikon

renovimet dhe ndërtimet e reja të objekteve shëndetësore;

2.6. Bën planin dinamik të realizimit të projekteve;

2.7. Monitoron, mbikëqyrë institucionet varës në aspektin shëndetësor, financiar dhe ligjor;

2.8. Në bashkëpunim me drejtorin bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;

2.9. Përgatitë shkresa, propozim vendime, aktet tjera që lidhen me natyrën e punës në Drejtori;

Objektivi 1. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore

1.1 Furnizimi i mirë me barna, reagjensa, material mjekësor, paijsje mjekësore dhe inventar i QKMF-së ,QMF-ve dhe AMF-ve

Gjatë vitit 2025, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është furnizuar me barna, material laboratorik, material stomatologjik, reagjensa për laborator mjekësor dhe paijsje mjekësore.

Objektivi 2: Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Në vitit 2025, në QKMF “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë, kanë filluar punën dhe 8 mjekë të rinj. Mjekët e rinj kanë nënshkruar kontratat e punës, pas përfundimit me suksese të procedurave të rekrutimit .

2.1. Drejtoria për Shëndetësi ka vazhduar me organizimin dhe përkrahjen e aktiviteteve në kuadër të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të personelit shëndetësor

Me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor të Mitrovicës.

Krahas aktiviteteve që Zhvillohen sipas planit të punës së koordinatorëve të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional , Drejtoria për Shëndetësi ka përkrahur ose ka organizuar edhe shumë

aktivitet të tjera për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional të profesionistëve shëndetësor që punojnë në (KPSH).

2.2. Është përfunduar moduli i tretë njëherit dhe i fundit në kuadër të projektit "Programi Transnacional i Trajnimit Shëndetësor", për 25 punëtor shëndetësor të QKMF-së ndjekës të këtij trajnimi.

Në kuadër të projektit "THTP" (Programi Transnacional i Trajnimeve Shëndetësore) është mbajtur moduli i tretë njëherit dhe i fundit në kuadër të këtij programi, pjesë e së cilit ishin 25 profesionistë shëndetësor të QKMF-së në Mitrovicë .

25 profesionistë shëndetësorë nga Qendra e Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr.Nexhat Çuni" përfunduan trajnimin tre ditor të modulit të tretë të programit "THTP" me temën "Vetëkujdesi për profesionistët shëndetësor".

Ky trajnim u mundësua në kuadër të Programit Transnacional të Trajnimeve Shëndetësore, pjesë e të cilit ishte edhe Komuna e Mitrovicës falë Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Organizatës Medica Gjakova, e cila ishte bartëse e projektit.

Në fazën e parë të projektit 8 profesionistë shëndetësor nga Mitrovica (4 nga QKMF dhe 4 nga Spitali i Përgjithshëm) janë trajnuar dhe certifikuar si trajner të këtij programi.

Në fazën e dytë trajnerët tanë të certifikuar trajnuan profesionistët e tjerë shëndetësor të QKMF-së, përkatësisht Spitalit.

Në QKMF grupi i parë i profesionistëve shëndetësorë kanë përfunduar të tre modulet e trajnimit 3 ditore të parapara në këtë projekt.

Programi është i akredituar nga OMK dhe OIK dhe është organizuar nga " Medica Gjakova" me përkrahje të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - BMZ dhe medica

2.3 Në QKMF u dorëzuan certifikatat e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional për infermierët

Në sallën e trajnimeve të QKMF-së u mbajt ceremonia e dorëzimit të certifikatave të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional për të gjitha ciklet e ligjeratave të Programit të Infermierisë, të mbajtuara në vitin 2024.

Ky program i Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional është i akredituar nga Oda e Infermierëve të Kosovës.

Objektivi 3: Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore

Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore që nënkupton ndërtimin e objekteve të reja shëndetësore dhe renovimin e objekteve aktuale shëndetësore mbetet një nga prioritetet e Drejtorisë Për Shëndetësi, më qëllimin e përmirësimit të kushteve të punës dhe ambienteve ku ofrohen shërbimet shëndetësore sipas standardeve bashkëkohore.

3.1 Përfundimi i ndërtimi të objektit të QKMF-së “Dr. Nexhat Çuni” objekt ky i cili ishte projekt madhor i realizuar nga Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me Shoqatën Bamiërëse “Jetimat e Ballkanit”. Objekti i ri i QKMF-së, më modern në rajon, është ndërtuar sipas standardeve më të larta mjekësore dhe inxhinierike. I pajisur me infrastrukturë të avancuar dhe ambiente për trajtime primare e preventivë, QKMF-ja do të ofrojë shërbime shëndetësore të nivelit të lartë, duke garantuar shërbime cilësore për të gjithë pacientët. Kjo qendër do të jetë shembull në kujdesin parësor shëndetësor në rajone cila që nga data 28.05.2025 ka filluar dhënien e shërbimeve shëndetësore të mjekësisë familjare, stomatologjisë, laboratorit të analizave, infermierisë (intervencës), barnatorja qendrore dhe këshillimorja për sëmundjet kronike, shërbimet e vaksinimit, rëntgenit, edukimit shëndetësor dhe promovimit të shëndetit, si dhe administratës

Shërbimet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Mitrovicës, do të ofrohen në një objekt modern i cili plotëson të gjitha kushtet për dhënien e shërbimeve dhe është realizuar përmes marrëveshjes së bashkëfinancimit me mes të Komunës së Mitrovicës dhe Shoqatës "Jetimat e Ballkanit".

3.2 Fillimi i renovimit të AMF-së Fidanishtë.

AMF Fishanishte është renovuar pjesërisht në vitin 2025

Objektivi 4 : Aktivitetet për parandalimin e sëmundjeve

Një prej objektivave kryesore të Drejtorisë për Shëndetësi është ndërmarrja e masave dhe zhvillimi i aktiviteteve për parandalimin e sëmundjeve përmes fuqizimit të Komponentës së Edukimit Shëndetësor dhe Promovimit të Shëndetit në kuadër të KPSH-së por edhe masave të tjera siq janë këshillimi, informimi, sensibilizimi dhe motivimi për jetë të shëndetshme dhe mbrojtje të shëndetit.

4.1 Në vitin 2025 nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit për projektin "Dhoma për Promovim dhe Edukim Shëndetësor "

Organizata Aksioni për Nëna dhe Fëmijë /Action for Mothers and Children (AMC) është organizatë jo-qeveritare (fondacion) me bazë në Prishtinë (Kosovë) e mbështetur nga UNICEF-i , që ka mision mbrojtjen e shëndetit dhe shpëtimin e jetëve të foshnjave dhe nënave në Kosovë.

AMC nëpërmjet zhvillimit të programeve dhe projekteve në sektorin e shëndetësisë ka për qëllim të përmirësojë kushtet e kujdesit shëndetësor ndaj nënave dhe foshnjave/fëmijëve, duke kontribuar kështu në uljen e shkallës së vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së foshnjave dhe nënave, rritjen e qasjes në shërbimet shëndetësore, ngritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve dhe ofrimin e edukimit shëndetësor të prindërve - të gjitha këto me promovimin e konceptit të pacientit të vendosur në qendër.

AMC kryen aktivitetet e saj duke mbështetur institucionet e Kosovës për ofrimin e kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën në kualitetin më të lartë të mundshëm. Këtë mbështetje e ofron duke identifikuar prioritetet kyçe dhe zbatimin e aktiviteteve që dalin nga këto prioritate të identifikuara; si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizata udhëheqëse ndërkombëtare për shëndetin e nënës dhe të foshnjave, e poashtu në bashkëpunim me udhëheqësit e hartimit të politikave shtetërore shëndetësore.

4.2 Organizimi i aktivitetit sensibilizues “ JAVA E SHËNDETIT ORAL 2025”

Drejtoria për Shëndetësi ,QKMF , Shkollat Fillore dhe të Mesme dhe organizatat partnere të Drejtorisë për Shëndetësi kanë realizuar fushatë në kuadër të 20 Marsit - Ditës Botërore të Shëndetit Oral e cila kishte për qëllim ndërgjegjësimin, edukimin shëndetësor dhe promovimin e rëndësisë që ka shëndeti i dhëmbëve dhe i gojës.

Në kuadër të kësaj fushate janë mbajtur ligjërata edukative shëndetsore dhe aktivitete të tjera për rëndësinë e shëndetit oral dhe higjienës orale në rreth 20 shkolla dhe institucione parashkollore të Mitrovicës prej 17 Mars deri më 24 Mars.

Ligjërata janë mbajtur nga stomatologët, asistentët dentarë dhe infermierët e Sektorit të Shëndetit Oral dhe Njësisë për Edukim Shëndetësor dhe Promovim të Shëndetit të QKMF-së.

4.3 Organizmi i seminarit për 2 prillin – “Ditën Ndërkombëtare të Autizmit”

U mbajt seminar për 2 prillin - Ditën Ndërkombëtare të Autizmit

Në Ditën Ndërkombëtare të Autizmit, Instituti për Studime Humane dhe Avancim të Lartë - Hasan Tahsin, në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit, organizuan një seminar ndërgjegjësues mbi sfidat dhe nevojat e fëmijëve me autizëm, i cili është mbajtur në hapësirat e Universitetit “Isa Boletini”.

Ligjëruese të këtij seminari ishin dy profesioniste nga fusha e psikologjisë dhe logopedisë, Festona Avdiu dhe Erza Preteni, të cilat ndanë ekspertizën e tyre mbi qasjet dhe metodat efektive për të mbështetur fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre.

Ky seminar theksoi rëndësinë e një qasjeje të integruar dhe mbështetëse për fëmijët me autizëm, duke inkurajuar bashkëpunimin e vazhdueshëm midis institucioneve arsimore, shëndetësore dhe komunitetit në përgjithësi.

4.4. Shënohet “Dita Botërore e Melanomës”

Në bashkëpunim me Shoqatën e Dermavenerologëve të Kosovës dhe Drejtorisë për Shëndetësi në sheshin “Mehë Uka” u shënuar Dita Botërore e Melanomës.

Melanoma është një nga llojet më të rrezikshme të kancerit të lëkurës. Ajo zhvillohet në qelizat ku prodhohet melanina, pigmenti që përcakton ngjyrën e lëkurës sonë. Njohja e simptomave të para të këtij lloji kanceri mundëson zbulimin dhe trajtimin e tij, përpara se sëmundja të përhapet. Melanoma mund të trajtohet suksesshëm, nëse zbulohet në kohë.

Specialistë të dermatovenetologjisë dhe infermierë të repartit të dermatovenerologjisë të Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" të Mitrovicës në sheshin e qytetit ofruan këshilla shëndetësore për qytetarët lidhur me melanomën malinje dhe masat për zbulimin e hershëm dhe parandalimin e saj.

4.5. Shënohet “Dita Botërore e Hipertensionit”

Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Hipertensionit 17 Maji, Njësia për Edukim Shëndetsor dhe Promovim të Shëndetit e QKMF-së zhvilloi një aktivitet në Sheshin “Mehë Uka” gjatë të cilit përveq matjes së tensionit arterial për qytetarëve të nteresuuar iu ofruan edhe këshilla dhe informata të rëndësishme lidhur me hipeptensionin arterial, faktorët e rrezikut, pasojat dhe masat parandaluese të këtyre pasojave.

Hipertensioni arterail është sëmundje kronike e cila prek më shumë se 30% të popullatës së moshës madhore në gjithë botën dhe shumë prej tyre nuk janë në dijeni që vuajnë nga ky problem.

Gjatë këtij aktiviteti dhjetra qytetarë kanë kontrolluar tensionin arterial dhe në mesin e tyre ka pasur edhe të tillë se nuk e kanë ditur që kane tension të lartë të gjakut dhe për këtë janë udhëzuar që të vazhdojnë konsultimet me mjekun familjarë dhe specialistët përkatës.

4.6. Është organizuar “Java Botërore e Ushqyerjes me Qumësht Gjiri 2025”

Në kuadër të shënimit të Javës Botërore të Ushqyerjes me Qumësht Gjiri, e cila këtë vit është mbajtur nën moton globale për përkrahjen dhe promovimin e gjidhënies, Njësia për Edukim Shëndetësor, Këshillim dhe Promovim të Shëndetit pranë QKMF-së në Mitrovicë ka zhvilluar një sërë aktiviteteve edukative dhe informuese me nënat e reja dhe gratë shtatzëna të komunitetit.

Qëllimi i aktiviteteve ishte që të rritet vetëdija për rëndësinë e gjidhënies si faktor themelor për shëndetin e nënës dhe fëmijës, dhe të ofrohet mbështetje profesionale për praktikën e suksesshme të ushqyerjes me gji.

Aktivitetet kryesore të zhvilluara kanë përfshirë:

- Këshillim individual mbi teknikat e duhura të gjidhënies;
- Demonstrime praktike me ndihmën e modeleve edukative (kukulla foshnje);
- Informim i detajuar mbi përfitimet e gjidhënies për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës;
- Shpërndarje të materialeve edukative për pjesëmarrësit.

4.7. Është mbajtur trajnimi dy ditor për dhënien e ndihmës së parë për stafin e Institucionit Parashkollor "Dritë Dielli"

U mbajt trajnimi për dhënien e ndihmës së parë për stafin e Çerdhës së re të fëmijëve në Shipol Në Çerdhën e re të fëmijëve në Shipol është realizuar trajnimi për ofrimin e ndihmës së parë për edukatorët dhe stafin teknik të këtij institucioni për të fuqizuar aftësitë dhe shkathtësinë e personelit të këtij institucioni të ri parashkollor për të ofruar ndihmën e parë në çfarëdo rrethane që rrezikohet shëndeti i fëmijëve.

Ky aktivitet është organizuar nga Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Drejtoria e Çerdhës ndërsa është zhvilluar nga Dr.Valon Caka mjek i Sektorit të Mjekimit Urgjent në QKMF , si dhe z.Bajram Rama, kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare - Bair 2 .

4.8. Në kuadër të “Ditës Botërore të Zemrës”,

Ekipi i infermierëve të Edukimit Shëndetësor dhe Promovimit në Komunitet nga QKMF “Nexhat Çuni” ka zhvilluar një aktivitet ndërgjegjësues në shesh, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit dhe kujdesit ndaj shëndetit kardiovaskular.

Gjatë aktivitetit, qytetarëve u janë ofruar:


- Matje të tensionit arterial, pulsit dhe saturimit të oksigjenit (SpO₂)
- Matje të gjatësisë dhe peshës trupore
- Këshilla profesionale mbi mënyrën e jetesës së shëndetshme, rëndësinë e aktivitetit fizik, ushqyerjes së balancuar dhe ndalimin e zakoneve të dëmshme si duhani dhe alkooli.

Ky aktivitet kishte për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit për faktorët e rrezikut që ndikojnë në shëndetin e zemrës dhe të nxisë kujdesin e vazhdueshëm ndaj vetes përmes kontrollave periodike dhe zakoneve të shëndetshme të jetesës.

Në këtë ditë simbolike, stafi ynë përcolli mesazhin se shëndeti i zemrës është përgjegjësi e secilit prej nesh, dhe se çdo hap i vogël drejt një jete më të shëndetshme ka ndikim të madh në parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare.

4.9. Është organizuar Kampanja për Tetorin Rozë “Muajin për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit”

Drejtorja për Shëndetësi e Komunës së Mitrovicës së bashku me institucionet shëndetësore të Komunës tonë, me Shoqërinë civile ,OJQ-të, Gratë Asambleiste e të tjerë kanë realizuar aktivitete edukativo-shëndetësore për muajin Tetor me qëllim të ndërgjegjësimit dhe senzibilizimit e parandalimit për këtë sëmundje, aktivitete këto të cilat janë realizuar përmes kësaj agjende :

KOMUNA E MITROVICËS
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI

TETORI ROZË 2025

DATA	AKTIVITETI	VENDI
01.10.2025-11:00	Ndriçimi i objektit të QKMF-se	QKMF
06.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	SHFMU "Aziz Sylejmani" Suhodoll
08.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	QKMF
13.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	Lagjja Adem Voca*
14.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	QKMF
15.10.2025-11:00	Organizojnë Marshin-e perbashket	Sheshi i Qytetit-Marsh
17.10.2025-11:00-14:00	Karvani Shëndetësor "per SHËNDETJE"	Sheshi i Qytetit
20.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	Hendikos
20.10.2025-11:00	Sesione sensibilizuese	Lagjja "Adem Voca"
22.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	QKMF
23.10.2025-11:00	Sesione sensibilizuese	Shoqata e te Shurdherve
24.10.2025-13:00	Fushatë ndërgjegjësuere	Sheshi i Qytetit
29.10.2025-10:00	Sesione sensibilizuese	QKMF
Gjate muaj Tetor	Ligjerata vetëdijësuese Ligjerata vetëdijësuese Ligjerata vetëdijësuese	Lagjja e re Frasher Lagjja* Adem Voca* SHML

4.10 “Karvani Shëndetësor” për promovimin e edukimit shëndetësor

Në sheshin “Mehë Uka “ në Mitrovicë u mbajt karvani shëndetësor “përSHËNDETje “ organizuar nga OJQ Mundësia në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF “Nexhat Çuni”, ku popullata u informua për faktorët e rrezikut të sëmundjeve Jo të transmetueshme (SJT) rreziqet dhe dobitë e dietës ushqimore, ekspozimin ndaj tymit të duhanit, konsumimi i alkoolit, rëndësinë e aktivitetit fizik.

Stafi i QKMF bëri matjen e glikemisë, tensionit arterial, BMI dhe ofroi informata të rëndësishme për shëndetin.

Profesionistet shëndetësor ofruan këshilla dhe informata për Kancerin e Gjirit- në kuadër të muajit Rozë.

Karvanit iu bashkuan edhe aktivistet e lagjes “Adem Voca “ dhe nxeneset e Kosovo Leadership Academy, të cilat shperndanë materiale promovuese dhe ekspozuan produkte të punuara kushtuar muajit Rozë.

Fushata “përSHËNDETje “ zbatohet në kuadër të projektit AHQ i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe zbatohet nga Swiss TPH dhe ka për qëllim informimjn e popullates per sëmundjet jo të transmetueshme (SJT)

4.11. Shënohet Dita Botërore e Diabetit

Në kuadër të Ditës Botërore të Diabetit, stafi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në bashkëpunim me Sektorin Këshillimor të QKMF “Nexhat Çuni”, organizoi një aktivitet ndërgjegjësues me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit në Sheshin “Mehë Uka”.

Ky aktivitet u prit me interesim të madh nga qytetarët, të cilët patën mundësinë të marrin shërbime dhe informacione të rëndësishme lidhur me parandalimin, zbulimin e hershëm dhe menaxhimin e diabetit.

Shërbimet e ofruara gjatë aktivitetit:

- Matje falas të glukozës në gjak
- Matje të tensionit arterial
- Këshillime profesionale mbi ushqyerjen e shëndetshme
- Informim mbi aktivitetin fizik dhe rëndësinë e tij në parandalimin e diabetit
- Shpërndarje të materialeve edukative dhe broshurave të dedikuara

SHTOJCA 1.

Raporti financiar i Drejtorisë për Shëndetësi, përfshirë QKMF-në

Buxheti i planifikuar për vitin 2025 ishte 4,501,904.00 €, prej tyre:
3,640,154.00 € nga granti specifik i shëndetësisë,
80,000.00 € nga te hyrat vetaneke te komunes,
751,750.00 € nga granti i përgjithëshëm i Komunës dhe
30,000.00 € nga participimi në shëndetësi.

Pershkrimi	Stafi	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencionet	Shpenzimet Kapitale	Totali
DSH	299	2,808,622.00	908,132.00	86,400.00	80,000.00	618,750.00	4,501,904.00
Grantet Qeveritare		2,778,622.00	908,132.00	86,400.00	0.00	618,750.00	4,391,904.00
Të hyrat vetanake		30,000.00	0.00	0.00	80,000.00	0.00	110,000.00
Financimi i jashtëm		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
ADMINISTRATA	5	33,000.00	100,000.00	0.00	80,000.00	618,750.00	831,750.00
Grantet Qeveritare		33,000.00	100,000.00	0.00	0.00	618,750.00	751,750.00
Të hyrat vetanake		0.00	0.00	0.00	80,000.00		80,000.00
Financimi i jashtëm 22							0.00
QKMF	294	2,775,622.00	808,132.00	86,400.00	0.00	0.00	3,670,154.00
Grantet Qeveritare		2,745,622.00	808,132.00	86,400.00	0.00	0.00	3,640,154.00
Të hyrat vetanake		30,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00	30,000.00
Financimi i jashtëm 22							0.00

Ndërsa me bartje e te hyrave nga viti 2024 projektit “Rregullimi i oborrit të QKMF-se Dr. Nexhat Çuni” i janë shtuar edhe 60,555.00 €

Projektet Kapitale

Projektet Kapitale për vitin 2024 i shpërndare sipas projektëve dhe emertimeve

Programi/Emërtimi i projektit	2025		
	Granti qeveritar 10	Të hyrat vetanake 22	<i>TOTAL 2025</i>
Administrata	618,750.00	60,555.00	679,305.00
Ndërtimi i QKMF-së Dr. Nexhat Çuni - Mitrovicë	326,100.00		326,100.00
Rregullimi i oborrit të QKMF-se Dr. Nexhat Çuni	100,000.00	60,555.00	160,555.00
Rregullimi i AMF Fidanishte	12,650.00		12,650.00
Pajisje Mjekesore për QKMF-ne e re (Pajisje Laboratorike, Stomatologjike, Pajisje Radiologjike dhe pajisje të Mjekesise Familjare)	180,000.00		180,000.00

Ndërsa me bartje të hyrave nga viti 2024 projektit “Rregullimi i oborrit të QKMF-se Dr. Nexhat Çuni” i janë shtuar edhe 60,555.00 €

Shpenzimi i Buxhetit

Buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë është realizuar 99.87 %

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Shpenzimet nga Granti	Shpenzimet nga te Hyrat	Shpenzimet nga Vendimi i Qeverise	Totali i Shpenzimeve	Indexi %
Paga dhe mëditje	2,808,622.00	2,862,322.37	0.00	0.00	2,862,322.37	101.91
Mallra dhe Shërbime	908,132.00	857,926.75	0.00	0.00	857,926.75	94.47
Shpenzime Komunale	86,400.00	84,466.59	0.00	0.00	84,466.59	97.76
Subvencione	80,000.00	80,000.00	0.00	0.00	80,000.00	100.00
Shpenzime Kapitale	679,305.00	671,949.12	0.00	0.00	671,949.12	98.92
Totali	4,562,459.00	4,556,664.83	0.00	0.00	4,556,664.83	99.87

Raporti vjetor i punës së Drejtorisë për Shëndetësi

Buxheti i Administratës së Drejtorisë për Shëndetësi është realizuar 95.30 %

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Shpenzimet nga Granti	Shpenzime ne proces	Shpenzimet nga Vendimi i Qeverise	Totali i Shpenzimeve	Indexi %
Paga dhe mëditje	33,000.00	41,950.25	0.00	0.00	41,950.25	127.12
Mallra dhe Shërbime	100,000.00	56,440.88		0.00	56,440.88	56.44
Shpenzime Komunale	0.00		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
Subvencione	80,000.00	80,000.00	0.00	0.00	80,000.00	100.00
Shpenzime Kapitale	679,305.00	671,949.12	0.00	0.00	671,949.12	98.92
Totali	892,305.00	850,340.25	0.00	0.00	850,340.25	95.30

Buxheti i QKMF-së është realizuar 100.99 %

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Shpenzimet nga Granti	Shpenzimet ne proces	Shpenzimet nga Vendimi i Qeverise	Totali i Shpenzimeve	Indexi %
Paga dhe mëditje	2,775,622.00	2,820,372.12			2,820,372.12	101.61
Mallra dhe Shërbime	808,132.00	801,485.87		0.00	801,485.87	99.18
Shpenzime Komunale	86,400.00	84,466.59	0.00	0.00	84,466.59	97.76
Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
Shpenzime Kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
Totali	3,670,154.00	3,706,324.58	0.00	0.00	3,706,324.58	100.99

SHTOJCA 2. **Subvencionet**

Drejtorja për shëndetësi ka realizuar mbështetjen financiare për shpenzime me barna dhe trajtime mjekësore për të gjithë qytetarët që kanë aplikuar gjatë vitit 2025.

Gjithsej janë subvencionuar 695 qytetarë, duke pasur prioritet të sëmuret me sëmundje kanceroze ku shuma totale ka arritu në vlerë prej 80,000.00€.

SHTOJCA 3.

Shqyrtimi i lëndëve në Intranet

Drejtorja për Shëndetësi, për vitin 2025, në intranet janë realizuar 1930 kërkesa, të cilat janë parashtruar nga perosnat fizik dhe juridik.

Raporti i shqyrtimit të lëndëve dhe statusit të lëndëve në mënyrë tabelare janar- dhjetor 2025

Miratuara	Proces	Refuzuara	Anuluar	Ceduar	Totali
743	1	764	0	422	1930

SHTOJCA 4.

DONACIONET

Donacion nga RAD Center me material shëndetësor për Ambulantën në lagjen “Adem Voca”

Drejtorja për Shëndetësi në Komunën e Mitrovicës ka pranuar një donacion të rëndësishëm me pajisje dhe materiale shëndetësore nga Qendra e Dokumentimit për Romë dhe Ashkali “RAD Center”, me financim nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Në ceremoninë e dorëzimit të donacionit ishin të pranishëm drejtori i Shëndetësisë, z. Fahri Shabani, drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, z. Fevzi Sylejmani, si dhe drejtori i organizatës RAD, z. Bekim Sylja.

Donacioni përfshin një gamë të gjerë pajisjesh mjekësore si: tensionmetra digjitalë dhe manualë, aparate për matjen e sheqerit në gjak, traka One Call Plus, stetoskopë, peshojë për foshnje dhe të rritur, karrige statike, aparate për inhalim, pulsoksimetra, si dhe materiale harxhuese si shiringa, kanula, gaza sterile, alkool, maska mbrojtëse dhe doreza jo sterile.

Këto pajisje dhe materiale janë dedikuar për Ambulantën e Mjekësisë Familjare në lagjen “Adem Voca”, dhe pritet të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e kësaj zone.

NJË AUTOAMBULANCË E RE PËR QKMF-NË

Në vitin 2025 Drejtoria për Shëndetësi e Komunës së Mitrovicës ka pranuar donacion një autoambulancë me të gjitha pajisjet për QKMF-në , nga Ministria e Shëndetësisë.

Kjo autoambulanca do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve shëndetsore nga ana e QKMF-ve të komunave përfituese të këtij projekti.

Me autoambulancë e re QKMF e Mitrovicës e rrit në shtatë numrin e autoambulancave që ka në dispozicion për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për qytetarët.